

LIGJ
Nr.8334, datë 23.4.1998

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE QË VEPROJNË NË SEKTORËT
JOSTRATEGJIK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

Paketë aksionesh të shoqërive tregtare ose ofertë për privatizim është kuota e aksioneve, që shteti si pronar i vetëm, i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, shpall për privatizim.

Kërkesë është vlefë në lekë, lekë ose bono privatizimi, që investohen për të blerë aksione në shoqëritë tregtare që privatizohen.

Kapitali themeltar është kapitali i shoqërisë që figuron në vendimin e gjykatës për regjistrimin e saj si person juridik. Vlera e truallit, brenda kufijve të shoqërisë është pjesë e pandarë e këtij kapitali.

Formula e privatizimit është ndarja e aksioneve të shoqërisë në:

Paketë aksionesh është paketa e aksioneve që i ofrohet blerësit.

Kjo paketë shitet me lekë.

Paketa e aksioneve për ish-pronarin e truallit është pjesa e aksioneve me të cilat ish-pronari i truallit hyn në shoqërinë tregtare pa pjesëmarrjen në ankand.

Ish-pronarët e truallit si subjekte kërkuese kanë të drejtë të marrin aksione në përpjestim me vlerën e truallit të njohur, në bazë të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Vlera e truallit përcaktohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kompensimi në përqindje, i caktuar në raport me pjesën tjetër të kapitalit të shoqërisë, mbetet i pandryshuar, pavarësisht nga rezultatet e ankandit.

Paketa e aksioneve për publikun është pjesa e aksioneve që i ofrohet publikut dhe punonjësve të shoqërisë në këmbim të bonove dhe lekëve të privatizimit. Punonjësit e shoqërisë kanë të drejtë të shkëmbejnë me vlerë nominale bonot e tyre dhe ato të familjes me aksione të shoqërisë.

Punonjës të shoqërisë konsiderohen punonjësit aktualë dhe ata të trajtuar me asistencë sipas ligjit nr.7521, datë 30.10.1991 " Për përkrahjen sociale për personat që dalin pa punë nga zbatimi i reformës ekonomike", një vit para publikimit të shoqërisë për privatizim.

Paketa e aksioneve shtetërore është pjesa e aksioneve që mbahen nga shteti.

Neni 2

Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit përcakton formulën e privatizimit pas përcaktimit të pjesës së aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe punonjësit e shoqërisë dhe, së bashku me dokumentacionin përkatës të shoqërive, i vë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

Neni 3

Forma e privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare është ankandi, i cili organizohet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Në raste të veçanta Këshilli i Ministrave cakton si formë privatizimi tenderin dhe, në përfundim të tij, vendos për privatizimin e paketës së aksioneve.

Neni 4

Privatizimi për paketat e aksioneve të shoqërive tregtare, nëpërmjet ankandit, zbatohet fillimisht për paketën që i ofrohet blerësit.

Neni 5

Nga të ardhurat e shitjes së paketës së aksioneve përfitojnë:

- Agjencia Kombëtare e Privatizimit 5 për qind të vlefës fillestare të shpallur. Kjo vlefë kalon në degën e thesarit për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit 20 për qind të vlerës së shitjes, për fond zhvillimi të ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare shtetërore. Kriteret e administrimit dhe përdorimit do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave

Diferenca e vlerës së shitjes kalon në buxhetin e shtetit.

Neni 6

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Neni 7

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2082, datë 8.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**